

I nderuar Zoti Kryetar i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Nënshkrimi i këtij memorandumit është formalizimi i bashkëpunimit midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë së Tiranës, bashkepunim i cili ka si partner real të gjithë juve, përfaqësuesit e biznesit.

Konkurrenca është një fenomen i pashmangshëm i tregut, realizimi me efektivitet i së cilës kërkon kuadrin e vet ligjor dhe institucional. Ky kuadër realizohet nëpërmjet zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës.

Komuniteti i biznesit është i interesuar për një funksionim sa më normal të tregut dhe të mekanizmave të tij për rritjen e produktivitetit të përdorimit të burimeve që sjellin rritjen e përgjithshme të mirëqënies së konsumatorëve. Në këtë këndvështrim, komuniteti juaj është një nga aleatët kryesorë të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, si një nga institucionet publike të angazhuara në mënyrë të drejtëpëdrejtë me krijimin e një sistemi, i cili garanton funksionimin e mekanizmave të tregut, synon mbrojtjen e konkurrencës në tregun e brendshëm nga shtrembërimet e praktikave anti-konkurrese duke kontribuar për një ekonomi të lirë dhe funksionale të tregut.

Por në vetvete, zbatimi i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe i Politikës së Konkurrencës shtron si domosdoshmeri krijimin e një ambjenti të favorshëm për zhvillimin e aktivitetit të ndërmarrjeve publike dhe private dhe njohjen e zbatimit të rregullave të qarta të lojës.

Një tryezë e ngjajshme me këtë u realizua vitin e kaluar nga Autoriteti, nëpërmjet të cilit u promovua Politika Kombëtare e Konkurrencës. Por sot, shkalla e përfaqësimit të biznesit tregon se Autoriteti i Konkurrencës nuk konsiderohet thjesht si një institucion administrativ, por si partner real për një bashkepunim më të ngushtë në funksion të barazisë në treg.

Konkurrenca reale dhe e fortë është kyç për konkurueshmërinë e ekonomisë. Konkurrenca sjell rritjen e produktivitetit dhe nxit kompanite ta bazojnë aktivitetin e tyre në novacionin. Ky pohim nuk është thjesht një pohim

teorik, por një domosdoshmëri praktike për një ekonomi që shpejt apo vonë do të jetë pjesë e ekonomisë globale. Bazuar në këtë argument, Autoriteti i Konkurrencës, duke zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës, kontribuon në rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së ekonomisë nëpërmjet: kuadrit të nevojshëm legjislativ, kapaciteteve të mjaftueshme administrative, dhe ndërmarrjes së veprimeve profesionale në zbatim të ligjit.

Realizimin e kësaj sfide Autoriteti i Konkurrencës e konsideron të lidhur ngushtë me menaxhimin e duhur të politikës së konkurrencës për një konkurrencë efektive në treg nëpërmjet :

- Rritjes së forcës detyruese të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ndaj ndërmarrjeve,
- Nëpërmjet advokatisë së konkurrencës,
- Nëpërmjet zbatimit të parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive nga të gjithë hartuesit e akteve normative në Republikën e Shqipërisë.

Të nderuar partnerë, besojmë se kjo marrëveshje bashkëpunimi përbën vetëm fillimin e një bashkëpunimi dhe mirëkuptimi në zbatim të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë dhe në përputhje me ligjin dhe me rregulloret bazë që përbëjnë të drejtën e konkurrencës në Shqipëri.